

VENDIM
Nr. 53, datë 29.3.2022

**MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “ADA SOLAR SE” SHPK NË VEPRIMTARINË
E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 4, pika 1, germa “e”, nenit 5, pika 1, germa “e”, nenit 13, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 29.3.2022, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 406 prot., datë 24.3.2022, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi licencimin e shoqërisë ‘ADA Solar SE’ sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 37, datë 3.3.2022, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “ADA Solar SE” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

- ERE, me shkresën nr. 70/6 prot., datë 4.3.2022, bëri njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (datë 18.3.2022), nuk rezultoi të kishte të tilla.

- Në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, aplikanti duhet të depozitojë në ERE formatin dhe dokumentacionin për aplikim, dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor, dokumentacionin financiar dhe fiskal dhe dokumentacionin teknik për aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.

Sa rezulton nga ky aplikim, shoqëria ka përcjellë tërësisht dokumentacionin e kërkuar, si më poshtë:

- formati dhe dokumentacioni për aplikim, neni 9, pika 1, germa: “a”, “b”, “c”, plotësuar;
- dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor, neni 9, pika 2, germa: “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, plotësuar;
- dokumentacioni financiar dhe fiskal, neni 9, pika 3, germa: “a”, “b”, “c”, “d”, plotësuar;
- dokumentacioni teknik për aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike, neni 9, pika 4.8, germa: “a”, “b”, “c”, plotësuar. Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për t’u pajisur me licencë në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike nga ERE, në zbatim të aneksit A, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “ADA Solar SE” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara.

Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti